**Republika e Kosovës**

**Republika Kosova - Republic of Kosovo**

***Qeveria - Vlada - Government***
***Ministria e Industrisë, Ndërmarrësisë dhe Tregtisë***

***Ministarstvo Industrije, Preduzetništva i Trgovine - Ministry of Industry, Entrepreneurship and Trade***

***Kabineti i Ministres – Kabinet Ministra- Cabinet of the Minister***

| | |
|---|---|
| DATË/A: | 23.08.2021 |
| REFERENC-Ë: | 03/2021 |
| PËR/ZA/TO: | Zyra Kombëtare e Auditimit |
| CC: | Z. Irfan Lipovica - Zv. Sekretar i Përgjithshëm / MINT<br>Z. Haki Maxhuni- Drejtor i NJAB / MINT |
| PËRMES/PREKO/THROUGH: | |
| NGA/OD/FROM: | Znj. Rozeta Hajdari - Ministre / MINT |
| TEMA/SUBJEKAT/SUBJECT: | Plani i zbatimit të rekomandimeve të auditimit për vitin 2020 |

I/e nderuar,

Me këtë shkresë iu dërgojmë planin e zbatimit të rekomandimeve të dhëna në raportin e auditimit lidhur me pasqyrat financiare për periudhën 01.01.2020 deri me 31.12.2020, planin e gjeni të bashkangjitur.

Me respekt

# Republika e Kosovës
**Republika Kosova-Republic of Kosovo**
*Qeveria - Vlada – Government*

*Ministria e Tregtisë dhe Industrisë - Ministarstvo Trgovine i Industrije - Ministry of Trade and Industry*

Data: 23.08.2021

**Plani i implementimit të rekomandimeve të dhëna në raportin e dhënë nga auditorët e Zyrës Kombëtare të Auditimit – për vitin 2020**

| Nr i çështjes/ Zyra Kombetare e Audititmit | Komente /MINT | Afati për implementim |
|---|---|---|
| **Çështja A1** – Mangesi ne projektin ,, Ndertimi i Infrastruktures per Parkun e Biznesit ne Lumadh | Rekomandimin e dhënë e kemi marrë me seriozitet. Meqenëse projekti është në proces, MINT do të marrë të gjitha masat në mënyrë që të mos tejkalohet vlera totale e projektit. Gjithashtu do të jemi të kujdesshëm që mos të bëjmë ndryshim të pozicioneve, gjithashtu, do të jemi të kujdesshëm në hartimin e referencave, duke qartësuar çdo pozicion. Ndërsa lënda në fjalë do të dërgohet për hetim në organet relevante.<br><br>Do të adresohen shkeljet e bëra duke u bazuar në legjislacionin në fuqi. | Në vazhdimësi |

| | | |
|---|---|---|
| **Çështja B1-** Kompenzimi i punonjesve pa vijueshmeri ne pune - | Ministria e Tregtisë dhe Industrisë disa herë i 'u është drejtuar MPB-së përmes kërkesave ku është kërkuar një objekt për akomodimin për punë të pjesëtarëve të komunitetit serb sipas Marrëveshjes se Brukselit për shuarjen e të ashtuquajturës "*Mbrojtja Civile (MC)*" ku ata do të mund të jepnin kontributin e tyre në punë, si dhe do të mund të përcjellim vijueshmërinë e tyre pasi edhe janë të pajisur me kartela. Përkundër kërkesave të vazhdueshme MTI tani MINT nuk ka pranuar asnjë përgjigje nga institucioni përkatës.<br><br>Andaj duke u gjendur në këtë situatë MINT e ka të pamundur të sigurojë vijueshmërinë e tyre të punës. | MINT do ta trajtoj këtë çështje përsëri, gjatë muajit gusht dhe shtator. |
| **Çështja A2** - Realizim i shpenzimeve në mungesë të kontratës valide | Është ngritur në nivel më të lartë institucional dhe jemi në pritje të lidhjes së kontratës, për këtë e kemi respektuar rekomandimin e ZKA-së. Vazhdimisht kemi bërë kërkesë në MPB dhe së fundmi e kemi përsëritur në qershor të këtij viti dhe jemi njoftuar se kontrata është para nënshkrimit nga MPB. | MINT do ta implementon në momentin e nënshktimit të kontratës nga MPB-ja. |
| **Çështja A3** - Tjetërsim i pasurisë pa aprovim paraprak nga MF | Automjetet e shitura të cilat ishin me vlerë zero në raportin e SIMFK janë larguar nga sistemi). | Rekomandimi është zbatuar nga MINT. |

| | | |
|---|---|---|
| **Çështja A4** - Mangësi në regjistrin kontabël të pasurisë. | Këtu është fjala për dy laborator, njëri është laborator mobil kurse tjetri është laborator statik. Referuar çështjes të ZKA këto dy asete do të regjistrohen sipas rekomandimit të ZKA. | Në muajin shtator. |
| **Çështja C1** - Mangësi në inventarizim të pasurive jo financiare | Lidhur me rekomadimin e dhënë tek çështja C1, MINT do ta zbatojë. Ne do të formojmë një komision i cili do të bëjë harmonizimin e gjendjes faktike të aseteve me regjistrat kontabël i cili do të mundëson konfirmimin e ekzistencës reale të pasurisë dhe do të mundësojë prezentimin e gjendjes së plotë dhe të saktë të pasurisë në Pasqyrat Finaciare. | Në muajin tetor. |

| | | |
|---|---|---|
| **Rekomandimi 10 - Llogaritë e arkëtueshme** Ministri duhet të siguroj se pas aplikimit të gjithë mekanizmve tjër ligjor në inkasimin e të arkëtueshmeve të vonuara, në rastet e mosrespektimit të kushteve të kontratës nga operatoret të shqyrtoj mundësinë e shkëputjes së kontratave | Pasi KIESA bënë inkasimin e të arkëtueshmeve, do të sigurojmë se do të aplikohen të gjitha mekanizmat ligjor për inkasimet e vonuara. Deri më tani inkasimet e vonuara janë proceduar në Avokaturën Shtetërore në kuadër të Ministrisë se Drejtësisë për procedurë përmbarimore. | Mundësia e shkëputjes së kontratave të cilat janë të nënshkruar nga MINT dhe Komuna e Drenasit si qiradhënës dhe nga Qiramarrësit do të adresohet në bordin e Parkut të Biznesit në Drenas. |

**Plani i rekomandimeve të dhëna në Raportin e Auditmit për Pasqyrat Financiare për periudhen 2019, pjesërisht të zbatuara dhe të pa zbatuara.**

**Rekomandimi** Nr. 3. Pagat dhe Meditjet – është përsëritur edhe në këtë vitë te çështja B1
**Rekomandimi Nr. 10** është zbatuar pjesërisht – MINT do të merr të gjitha masat për trajnimin e zyrtarëve te pasurisë.
**Rekomandimi Nr 11.** Llogaritë e arkëtueshme - Do të angazhojmë zyrtarët përgjegjës të KIESES për të adresuar te avokatuara e shtetit pranë Ministrisë së Drejtësisë.